



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA SOLEMNE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME  
RASTIN E MIRATIMIT TË DEKLARATËS SË MIJËVJEÇARIT, TË MBAJTUR  
MË 17 TETOR 2008

SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA POVODOM  
USVAJANJA DEKLARACIJE MILENIJUMA, ODRŽANE 17. OKTOBRA 2008.  
GODINE

OKTOBAR – SEPTEMBAR  
2008

## **R e n d i i d i t ë s**

Miratimi i Rezolutës për deklaratën e Mijëvjeçarit.

## **D n e v n i r e d**

Usvajanje Rezolucije o deklaraciji Milenijuma.

## **A g e n d a**

Approval of the Resolution for Millennium Declaration.

Seancën e kryesoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,  
Po e hapim seancën solemne, me të vetmen pikë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi dhe miratimi i Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për adoptimin e Deklaratës së Objektivave të Mijëvjeçarit**

Më lejoni të paraqes një fjalë të shkurtër hyrëse.

I nderuari President Sejdiu,  
I nderuari Kryeministër Thaçi,  
I nderuari përfaqësues i fushatës së Mijëvjeçarit, zoti Schmidt,  
I nderuari përfaqësues i Agjencionit të OKB-së në Kosovë, zoti Muring,  
Të nderuar përfaqësues të zyrave diplomatike dhe të ambasadave në Kosovë,  
Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,

Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën do të procedojmë Rezolutën për adoptimin e Deklaratës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Mijëvjeçarin.

Bota e sotme vazhdon të ketë dallime të mëdha shoqërore dhe ekonomike. Me qëllim të zhdukjes së varfërisë së skajshme dhe të urisë nga të cilat vuajnë rreth një miliard njerëz, të arritjes së shkollimit fillor për të gjithë, të promovimit të barazisë gjinore dhe të rritjes së rolit të gruas, të zvogëlimit të vdekshmërisë së foshnjave, të përmirësimit të shëndetit të nënave, të luftimit të sëmundjeve ngjitëse, të sigurimit të qëndrueshmërisë së ambientit dhe të krijimit të partneritetit global, këtu e tetë vjet më parë në Asamblenë e

Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara u miratua Deklarata e Mijëvjeçarit, të cilën e kanë nënshkruar 189 vende.

Objektivat për zhvillimin e Mijëvjeçarit, synojnë arritjen e disa standardeve, të cilat do të sigurojnë zhvillim dhe përmirësim të jetës së shoqërive të vendeve të përfshira në këtë proces. Vlerat sociale të marrëdhënies ndërkombëtare të shekullit XXI përfshijnë lirinë, barazinë, solidaritetin, tolerancën, respektin për natyrën dhe ndarjen e përgjegjësisë.

Orientimi botëror i Mijëvjeçarit ka për qëllim zhdukjen e hendeqeve dalluese brenda shoqërisë moderne dhe krijimin e kushteve të mirëqenies së përgjithshme.

Deri më 2015 të gjitha vendet, me forcat e veta, si dhe me përkrahje nga jashtë, synojnë tejkalimin e vështirësive që lidhen me zhvillimin e tyre njerëzor e ekonomik dhe përgjysmimin e varfërisë ekstreme, shkollimin elementar, reduktimin në tri të katërtat e vdekshmërisë së foshnjave, zbrapsjen e sëmundjeve ngjitëse e të tjera.

Për shkaqet që dihen, Kosova nuk ka mund të ishte nënshkruese e Deklaratës në Samiti e Mijëvjeçarit të vitit 2000, por sot, kur vendi ynë është i shpallur shtet i pavarur dhe është njohur ndërkombëtarisht, Kuvendi mund të adoptojë atë nëpërmjet Rezolutës së propozuar për miratim. Ky eveniment i sotëm koïncidon me Javën ndërkombëtare kundër varfërisë, kurse lufta kundër varfërisë përbën njërin nga 8 objektivat zhvillimore të Mijëvjeçarit.

Synimet, që dalin nga Deklarata e Mijëvjeçarit janë të rëndësishme për gjendjen aktuale në Kosovë. Politika e dhunës ndaj Kosovës dhe lufta kanë lënë pasojë të rënda në të gjitha fushat, si në varfërinë e theksuar, prapambetjen e arsimit, vdekshmërinë e lartë të foshnjave, shëndetin e pambrojtur të nënës, përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, dëmtimin e ambientit, e të tjera.

Objektivat për zhvillimin e Mijëvjeçarit i shërbejnë edhe agjendës evropiane të përfshirjes sociale në Kosovë. Me përfshirjen sociale, synohet zbutja e dallimeve sociale nëpërmjet lehtësimit të përfshirjes në punësim, burime, produkte dhe shërbime, duke parandaluar përjashtimin social dhe duke ndihmuar më të cenuarit nga ky përjashtim.

Kuvendi do të angazhohet për arritjen e objektivave për zhvillimin e mijëvjeçarit dhe do të mbështesë institucionet tjera, si dhe shoqërinë civile në këtë drejtim, sepse këto synime të përbashkëta kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, integrimin evropian të tij dhe partneritetin ndërkombëtar.

Miratimi i Rezolutës së Mijëvjeçarit në kohën kur Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore, ka rëndësi të veçantë, sepse këto dy institucione relevante financiare në botë janë palët kryesore për objektivat e Mijëvjeçarit në planin global.

Miratimi, përshtatja e kushteve konkrete të vendit, monitorimi dhe raportimi i arritjes së objektivave për zhvillimin e Mijëvjeçarit do t'i kontribuojnë zhvillimit njerëzor e ekonomik në Kosovë, por edhe solidaritetit ndërkombëtar me këto përpjekje.

Objektivat zhvillimore të Mijëvjeçarit nuk përbëjnë strategji zhvillimore me vete, por janë pjesë përbërëse e planifikimeve strategjike sociale dhe ekonomike. Në presim që Qeveria dhe institucionet tjera, në procesin e hartimit të politikave të strategjisë zhvillimore, të përgjithshme e sektoriale, të integrojnë objektivat për zhvillimin e Mijëvjeçarit duke i kthyer ato në veprime konkrete dhe të përditshme.

Zbatimi i objektivave do të kërkojë, gjithashtu, monitorim sistematik dhe raportim institucional të progresit.

Të ndodhur para objektivave kaq madhore, ne kemi nevojë për bashkimin e potencialeve, njohjen e sfidave dhe diskutimin e zgjidhjeve bashkërisht.

E ftoj Kuvendin e Kosovës që ta miratojë Rezolutën, duke i hapur kështu rrugë zbatimit të politikave të Deklaratës së Mijëvjeçarit dhe të partneritetit ndërkombëtar në Kosovë për arritjen e objektivave të saj.

Me miratimin Rezolutës, Kuvendi i Kosovës rikonfirmon përkushtimin e tij për partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera, shoqërinë civile dhe prezencën ndërkombëtare në Kosovë për arritjen e objektivave për zhvillim të Mijëvjeçarit dhe të agjendës evropiane të përfshirjes sociale.

Së fundi, dëshiroj t'i shpreh mirënjohje dhe falënderimin tonin të thellë ekipit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë për mbështetjen e deritashme dhe gatishmërinë që të na ndihmojë në procesin e realizimit të Objektivave zhvillimore të Mijëvjeçarit. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që të ftoj Presidentin e Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu, që t'i drejtohet Kuvendit me një fjalë rasti.

**PRESIDENTI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU:** Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi,

I nderuari Kryeministër i Republikës, Hashim Thaçi,

I nderuari zoti Schmidt, zoti Muring,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës, ministra, zëvendësministra dhe të nderuar pjesëmarrës,

Në shtator të vitit 2000, në Asamblenë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, kryetarë dhe përfaqësues shtetesh nga gjithë globi, miratuan Deklaratën e Mijëvjeçarit. Në themelet e kësaj Deklarate të Kombeve të Bashkuara është aspirata për

paqe të qëndrueshme, prosperitet dhe drejtësi. Po, njëherësh, edhe për më shumë dinjitet njerëzor, barazi, zhvillim social, ekonomik dhe kulturor.

Zonja e zotërinj,

Miratimi i sotëm i Deklaratës së Mijëvjeçarit nga Parlamenti i Republikës së Kosovës shpreh përkushtimin e institucioneve tona për realizimin e parimeve dhe të vlerave, të cilat do të mundësojnë që edhe vendi ynë të bëhet pjesë e progresit më të madh dhe integriteteve më të shpejta.

Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit përmbajnë objektiva thelbësore që u detyrohen si institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, po ashtu edhe shteteve veç e veç. Prandaj, Kosova si shtet sovran dhe i pavarur, pavarësisht se është më i riu në hartën politike të botës, e merr me përkushtim realizimin e këtyre Objektivave të përbashkëta botërore duke pasur vizionin mbi nevojën e masave konkrete, të shpejta dhe të koordinuara në partneritet ndërkombëtar.

Me këtë rast duhet theksuar se indikatorët ekonomikë, sikur edhe ata njerëzorë në vendin tonë, ende vazhdojnë të mbesin në një shkallë të pakënaqshme zhvillimi dhe për të ndryshuar këtë gjendje kërkohet veprim në një plan shumë të gjerë dhe kompleks.

Ne jemi të vetëdijshëm për ndërvarshmërinë midis rritjes ekonomike, redukimit të varfërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, do të jetë me interes që Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të inkorporohen në mënyrë adekuate në strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, si dhe në të gjitha strategjitë e tjera përcjellëse në nivel të ministrive dhe të fushave të tjera përkatëse. Kur e them këtë, kam parasysh se Strategjia e zhvillimit ekonomik të Kosovës do të reflektojë jo vetëm tek indikatorët financiarë, por edhe ndjeshmërinë ndaj varfërisë, vdekshmërisë së foshnjave, arsimit, mjedisit, AIDS-it dhe sëmurjeve të tjera. Kjo do të thotë, që të bëjë të mundur efektet pozitive në përmbushjen e objektivave deri në vitin 2015.

Reduktimi sa më i shpejtë dhe po kështu edhe zhdukja e varfërisë në një të ardhme të afërt në Kosovë është detyrim yni, prandaj shfrytëzoj rastin që të inkurajoj të gjitha institucionet dhe qytetarët për të vepruar me përkushtim në këtë plan dhe, përderisa të mos arrihet kjo, le të punojmë që ky synim kurrë të mos bie nga agjenda dhe të mos lihet në harresë nga askush.

Krijimi i mundësive më të mira të jetës për çdo njeri që njerëzit të mos vuajnë dhe të mos rrezikojnë ekzistencën e familjeve të tyre dhe mirëqenien e gjeneratave të ardhshme, mbetet objektiv relevant dhe parësor i institucioneve të Kosovës.

Politikat më aktive zhvillimore dhe sociale nënkuptojnë doemos edhe shtimin e formave të bashkëpunimit me institucionet dhe entitetet ndërkombëtare, për të tejkaluar problemet dhe gjendjen ekzistuese të pakënaqshme.

Deklarata e Mijëvjeçarit na obligon që parimet e saj të reflektojnë edhe në buxhetin e Kosovës, sikur edhe në buxhetet e vendeve të tjera. Pra, të kemi një buxhet ku do kenë vendin e duhur dhe të posaçëm linjat që do të mundësojnë zvogëlimin e varfërisë, zhvillimin e arsimit, qasjen dhe kujdesin e nevojshëm shëndetësor, arritjen e barazisë gjinore, e të ngjashme..

Të nderuar deputetë,

Do t'ju inkurajoja me këtë rast juve dhe po kështu edhe të gjitha institucionet e Kosovës që, duke u mbështetur në Deklaratën e Mijëvjeçarit, të punohet për një ndërlidhje aktive në raportet strategjia zhvillimore – buxheti dhe bashkëpunimi me mediat dhe shoqërinë civile, me ç'rast do të mundësohej krijimi i linjave dhe i aktiviteteve të përbashkëta në relacionin institucionet - mediat - shoqëria civile dhe publiku, si një parakusht i rëndësishëm për realizimin e objektivave të Mijëvjeçarit.

Kur e them këtë, kam parasysh se realizimi i shumë prej këtyre objektivave nuk varet vetëm nga investimet apo mjetet financiare, por edhe nga ndryshimi i vetëdijes dhe i qasjes ndaj problemeve ekzistuese. Në këtë kontekst, do të përmendja veçmas mortalitetin e foshnjave, shëndetin maternal, AIDS-in dhe barazinë gjinore.

Është me shumë interes shtimi i pjesëmarrjes dhe shtrirja sa më e gjerë e aktiviteteve në të gjitha nivelet, nëpërmjet reflektimit ndaj iniciativave të shoqërisë civile. Natyrisht, kjo do të mund të mbërrihet nëpërmjet politikave inkurajuese të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Republika e Kosovës në këto vite të ndërtimit të një shoqërie dhe të institucioneve të saj demokratike, e ndihmuar edhe nga bashkësia ndërkombëtare, ka miratuar një legjislacion që ndërlidhet edhe me objektivat e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara. Tashmë po funksionon një legjislacion në fuqi me shumë dimensione të volitshme dhe që po jep rezultate edhe në rrafshin praktik. Fjala vjen, ne kemi një Ligj bashkëkohor për barazinë gjinore dhe na mbetet që në një proces dhe kohë sa më të shkurtër atë edhe ta zbatojmë plotësisht.

Realizimin e Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015, krahas përmbushjes së kriterëve për integrim në Bashkimin Evropian, e vlerësojmë si sfida shumë të madhe, por edhe detyrim të mundshëm për t'u realizuar në pikat e veta më të ndjeshme.

Me angazhimin që sa më parë të arrijmë të anëtarësohemi në institucionet ndërkombëtare politike dhe financiare, duke u bërë pjesë e partneritetit global për një zhvillim të qëndrueshëm, ne presim mbështetjen e vendeve tjera, veçmas të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që janë edhe në vazhdimësi, që me përvojat e veta dhe në forma përkatëse, do të na ndihmojnë në qasjen dhe përmbushjen e vizionit për këtë proces.

Të nderuar deputetë,

Me aprovimin nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, sot edhe formalisht po deklarohemi se do të punojmë në përmbushjen e tetë parimeve të Deklaratës së Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara. Ne do të punojmë bashkërisht që qytetari i Kosovës të përfitojë thellësisht nga ky proces duke krijuar ndryshim në cilësinë e jetës në mënyrë që çdo njeri të ketë shëndet, edukim, strehim e siguri. Mbetet detyrë e përbashkët e institucioneve të Republikës së Kosovës vlerësimi real i ecurisë së jetësimit të obligimeve që dalin nga Deklarata.

Në këtë aspekt, unë si President i vendit, do të angazhohem dhe do të punoj për realizimin e plotë të këtyre obligimeve, duke u kujdesur për ndërlidhjen e të gjitha veprimeve jo vetëm në rrafshin e brendshëm, por edhe në atë të jashtëm.

Duke punuar bashkërisht dhe me përkushtim të përhershëm për të ardhmen tonë më të mirë dhe prosperuese, Synimet e zhvillimit të mijëvjeçarit do të bëhen realitet edhe në Republikën e Kosovës si një shtet i ri, por me përcaktime afatgjata të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të integriteteve. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KREYTARI I KUVENDIT: Ju faleminderit, zoti President! Ftoj, Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi për ta paraqitur fjalën e vet.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS HASHIM THAÇI: I nderuari President i Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu,

I nderuari Kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

I nderuari zoti Shmidt,

Të nderuar ministra, deputetë,

Të nderuar përfaqësues ndërkombëtarë,

Zonja dhe zotërinj,

Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran dhe demokratik që nga 17 shkurti i këtij viti.

Si shtet i ri, Republika e Kosovës ka përgjegjësi jo vetëm brenda kufijve të saj, por edhe ndaj familjes së shteteve sovrane dhe bashkësisë ndërkombëtare, me të cilat ndanë obligimin për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar në nivelin rajonal dhe atë global.

Deklarata e Mijëvjeçarit, e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 8 shtator 2000 dhe e mbështetur nga 189 shtete të botës, është në përputhje

me vizionin tonë në pikëpamje të parimeve dhe të vlerave të dinjitetit njerëzor, të barazisë dhe të përbashkësisë së të gjithë qytetarëve të shtetit tonë.

Objektivat zhvillimore të Mijëvjeçarit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara janë pjesë e rëndësishme e përmbushjes së obligimeve shtetërore të Republikës së Kosovës në rrafshin e brendshëm dhe atë global.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, sot po ndërmerr hapin historik të votimit të Rezolutës për miratimin Objektivave të Mijëvjeçarit, për:

- çrrënjosjen e varfërisë ekstreme dhe urisë,
- arsimin fillor për të gjithë,
- promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e gruas,
- zvogëlimin e vdekshmërisë së fëmijëve dhe përmirësimin e shëndetit të nënave,
- luftimin e HIV/EIDS-it, malaries dhe të sëmundjeve tjera,
- qëndrueshmërinë e ambientit, dhe
- partneritetin global për zhvillim.

Këto zotime janë dëshmi e lidhjes së ngushtë dhe ndërvarësisë midis rritjes ekonomike, zbutjes së varfërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Këto zotime kërkojnë që zhvillimi të bazohet në qeverisje të mirë, transparente dhe demokratike, sundim të ligjit dhe respektim të të drejtave të njeriut, standarde këto që tanimë i kemi instaluar në Kosovën e pavarur. Në veçanti, institucionet e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Kosovës do të angazhohen për:

- sigurimin e mundësisë për jetë me dinjitet, të lirë, pa uri, pa frikë dhe trysni të çfarëdo lloji,
- krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët,
- sigurimin e klimës së tolerancës dhe të diversitetit fetar, kulturor dhe gjuhësor, në të cilin do të sigurohet dialogu i mirëfilltë midis qytetarëve,
- shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore për zhvillimin e qëndrueshëm për brezat që do të vijnë,
- marrjen e përgjegjësive për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik.

Republika e Kosovës, prej sot merr zyrtarisht obligimet e saj për përmbushjen e këtyre objektivave.

Kjo tregon se ne nuk dëshirojmë të gëzojmë vetëm të mirat që sjellin integritet euroatlantike dhe integritet global, por që të jemi të gatshëm edhe t'i kontribuojmë bashkësisë ndërkombëtare dhe botës.

Miratimi i këtyre objektivave do ta forcojnë përkushtimin tonë ndaj këtij partneriteti global.

Pavarësia e Kosovës është faktor i paqes dhe i stabilitetit.



Objektivat e mijëvjeçarit i kontribuojnë zhvillimit dhe progresit në mbështetje të nismës globale për paqe dhe stabilitet në tërë botën.

Republika e Kosovës është e gatshme për të bashkëpunuar me bashkësinë ndërkombëtare në mbështetje dhe në realizimin e këtyre prioritetëve.

Republika e Kosovës do të ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar veprimin e ligjit, duke luftuar krimin e çfarëdo forme dhe duke i kontribuar lëvizjes së lirë të njerëzve dhe të kapitalit në mënyrë që të bëhet faktor i stabilitetit, të bashkëpunimit dhe të zhvillimit regjional, evropian dhe më gjerë.

Në veçanti, ne do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për luftimin e varfërisë së skajshme, të shkaktuar nga një periudhë të gjatë të ngecjes në zhvillim, të trysnisë sistematike dhe të keqmenaxhimit.

Në nivel të vendit po ndërtojmë një qeverisje të përgjegjshme dhe efikase, që do të veprojë në gjetjen e burimeve të brendshme dhe në ngritjen e kapaciteteve institucionale që mundësojnë nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe eliminimin e varfërisë.

Duke ndërtuar lidhjet e bashkëpunimit ndërkombëtar, ne do të kontribuojmë në zhvillimin e marrëdhënieve të mira me të gjithë fqinjët tanë.

Kosova me popullsinë më të re në Evropë, ka detyrë shtesë të përkujdesjes që fëmijët tanë të kenë qasje në shkollimin cilësor bashkëkohor.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka kuptuar me seriozitetin më të madh, duke ndërmarrë hapa të guximshëm në ndërtimin e shkollave dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet licencimit të arsimtarëve dhe të shkollave në të gjitha nivelet dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë.

Arsimimi cilësor është kuptuar si detyrë strategjike që mundëson aftësimin e të rinjve për punë dhe punësim produktiv.

Ne do të jemi të përgjegjshëm për ruajtjen e mjedisit. Do të bëjmë përpjekje sistematike që të krijojmë një ambient sa më të pastër, në mënyrë që brezat që vijnë, të kenë burime të mjaftueshme dhe të pastra.

Si vend që ka vuajtur shumë nga shkeljet e të drejtave njerëzore, ne respektojmë plotësisht Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe do të bashkëpunojmë me të gjitha vendet dhe organizatat e vullnetit të mirë për të promovuar të drejtat njerëzore, duke përfshirë këtu të drejtat për zhvillim. Do të përkujdesemi për të drejtat e minoritarëve, të grave, të fëmijëve dhe të individëve me nevoja të veçanta.

Qeveria e Kosovës do të veprojë në drejtim të krijimit të mundësive më të mira për sektorin privat, të organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile, që vlerat e

përmendura të bëhen pjesë e vizionit, të strategjisë dhe të veprimit të tërë shoqërisë dhe të institucioneve kosovare. Në këtë mënyrë, Republika e Kosovës do të kontribuojë në forcimin e rolit të Kombeve të Bashkuara, në të cilin aspirojmë dhe do ta meritojmë të anëtarësohemi sa më parë.

Të nderuar deputetë,

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ftoj të gjithë parlamentarët që ta votojnë Rezolutën. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Të nderuar të pranishëm, me ne sot në këtë ngjarje të rëndësishme ndodhet edhe zoti Schmidt, i cili ka mbështetur ekipin brenda Byrosë për politikë zhvillimore të UNDP-isë dhe ka përkrahur shtetet në përgatitjen e strategjive kombëtare për arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit. Si zëvendës drejtor i projektit: “Fushata e Mijëvjeçari të Kombeve të Bashkuara”, i drejtuar nga profesori Xhefri Sacsh, Guido ka shtyrë përpara Strategjinë praktike për arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit. E ftoj zotin Schmidt, ta marrë fjalën dhe t’i drejtohet Kuvendit të Kosovës.

GUIDO SCHMIDT:

Mr. President, Mr. Prime Minister, Mister present of the Assembly, Excellencies, Ladies and Gentlemen, it is a great honor and a great pleasure to be here with you on this important day. Kosovo has come a very very long way in recent years, great progress has been made on internal stability, institutions have been build up on the extraordinary difficult situations, the country has also recently adopted the first medium term expenditure framework to put as public finances on to longer term footing.

That’s why today I think marks and transitions towards looking into the future to embrace international development goals and to focus on long term task, the long term task of development. The millennium development goals which you are discussing here today provide a very important political but also substantial framework to put the challenges into stock of relieve. The challenges face young Kosovo abroad but they are also easily identifiable. Kosovo has the youngest population as was referred to it is land locked so the people are the greatest asset. The people here need education, they need more education, they need increased transition particularly into secondary education. We discussed just earlier today the importance also of modernizing the curricula and focusing on IT and other modern skills that are essential for an export based economy. There was a challenge of gender equality education, the particular challenge of insuring at the greater share of young girls transition complete primary school but also transition into secondary school. There was a challenge of infrastructure, there are particular challenges of health, I think here looking using the... one can identify infant mortality and child mortality as

particular challenge, those rates can be brought much much lower using improved and tested tools. There was also the challenge of tuberculosis and other infectious diseases.

These are all very very manageable challenges. Many countries have tackled these challenges successfully and I believe Kosovo can learn greatly from the experiences. Countries around the world have put in place a long term programs to tackle the challenges of health, education and infrastructure and I think the lessons from these successful programs can be made available here in Kosovo through agencies of the UN and other international organizations. Many other parts of Europe have also witnessed great transformation, great changes in the last two decades, the Baltic States, parts of the Former Yugoslavia, many of these parts are now on the course of successful development and again I think this holds important and really practical lessons for Kosovo. The first lesson I'd like to add in this course is that there was absolutely no substitute for political leadership and it is wonderful to be here with you today to witness the extent of consensus and leadership around in the development goals, because that is the deprave requirement for any international assistance to be effective. The second lesson as I have mentioned is these challenges are easily identifiable and the tours are known to address each one of them. It is a matter into engaging into adopting long terms strategies and pursuing them with a clear focus on outcomes and I believe with the development of main goals can provide wonderful framework to do so. Third it is important to look at the issue of accountability to make all parts of Government accountable this is of course with the Assembly playing the critical role and this is why it is such a great honor to be here today to witness the discussion and adoption of this resolution.

Using the MDG I believe Kosovo can accomplish several things, first to achieve clear focus on outcomes, the outcomes on health, education and infrastructure that matter into setting out a multi year frame work for achieving them. Second the challenges of health education are non political challenges, they don't depend on party one belongs to or the ethnicity one belongs to. These are basic human rights that need to be realized in the former basis for the longer term economic development. The many parts of this world have been very successful in using the millennium development goals as a long term framework to take politics out of crucial issue of service delivery, to take politics out of the provision of health, out of provision of education, out of the provision of infrastructure, that focusing on the long same share long term objectives and I believe that this opportunity of course is also available here in Kosovo. The third opportunity provided by MDG is to establish the clear accountability. We will be accountable for clear quantity of objectives and the fourth opportunity which has been referred to in the previous two speeches is to mobilize and energize the country and I want to add a score in a particularly I've seen the development goals to be extremely useful in explaining and playing simple languages to the people what the government and what the parliament would like to achieve to get them engaged in development and to get them to share in the vision for the people. The main development goals can be very powerful framework for mobilizing the civil society in the country and last but not least of course the millennium development goals are also a very important framework for structuring and organizing the collaboration with the international partners.

It is a declaration that every country, every government in the world has signed on to now and it really takes out the question of what is it that we want to achieve and it allows the important focus on how we can achieve it, what is it that the government of Kosovo can contribute and where are the areas that the international support is needed, what form should international support be and how can we convene and regulate\_\_ to review progress ...of what is worked and what is not worked. So, my role here is really to applaud your leadership, to encourage you on this very important part and to witness this truly historic day in the history of Kosovo. I believe international community will take notice of this step and I believe that it will form the adoption of this declaration in the important basis for a long term partnership with the international community but also as it is said none of this can be a substitute or replacement for the domestic leadership. The political leadership of all parties, of all parts of governments and of all members of the parliament and this is what I'm witnessing here today so, I congratulate you on this leadership and I wish you well on your parts towards achieving the millennium goals. Thank you

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, shumë zoti Shmidt!

Të nderuar deputetë, ju e keni tekstin e Rezolutës, po për hir të opinionit që na përcjell dhe të mysafirëve që janë në sallë, kisha ftuar zotin Naim Maloku, ta lexojë tekstin e Rezolutës së Kuvendit të Kosovës.

NAIM MALOKU:

Kuvendi i Republikës së Kosovës

## REZOLUTË

Duke ndërtuar shtetin e ri sovran dhe duke forcuar demokracinë funksionale,

Duke riafirmuar dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për respektimin e parimeve dhe të vlerave të marrëveshjeve ndërkombëtare,

Duke vlerësuar përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për një botë më të mirë, më të drejtë, më prosperuese e paqësore dhe me qëllim që aktivisht t'iu kontribuojë këtyre përpjekjeve,

Duke besuar se adoptimi i Deklaratës së Mijëvjeçarit, nga e cila rrjedhin Objektivat për zhvillim të Mijëvjeçarit, do të kontribuojë më tej në proceset e zhvillimit të Kosovës,

Duke pasur parasysh që Agjenda e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara është në përputhje me proceset e integritit evropian dhe duke rikonfirmuar edhe aspiratën e Kosovës për integrim evropian,

Me bindje që arritja e Objektiveve për zhvillim të Mijëvjeçarit do të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar,

I vetëdijshëm që përmirësimi i mirëqenies së gjithë qytetarëve të Kosovës nëpërmjet arritjes së Objektivave për zhvillim të Mijëvjeçarit, do të ndihmojë vendin që të forcohet si burim i stabilitetit të brendshëm dhe të rajonit,

Në frymën e parimeve dhe të vlerave të Kombeve të Bashkuara dhe me përpjekjet e shtuara për të arritur Objektivat për zhvillim të Mijëvjeçarit,

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

1. Aprovon Deklaratën e Mijëvjeçarit, sipas tekstit të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, A/RES/55/2, të datës 8 shtator 2000,
2. I kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës që të krijojë partneritete globale, si dhe mirëpret përkrahjen ndërkombëtare drejt arritjes së Objektivave për zhvillim të Mijëvjeçarit në Kosovë,
3. Inkurajon autoritetet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, shoqërinë civile, sektorin privat dhe organizatat ndërkombëtare që të përfshihen në procesin e arritjes së Objektivave të zhvillimit të Mijëvjeçarit, si dhe të monitorojnë e vlerësojnë përparimin deri në vitin 2015,
4. Përkushtohet që të miratojë kornizën e nevojshme ligjore dhe të krijojë politikat e duhura që mundësojnë arritjen e Objektivave për zhvillim të Mijëvjeçarit nëpërmjet strategjisë kombëtare për zhvillim,
5. Siguron mekanizma dhe kapacitete të duhura institucionale, si dhe burime financiare të cilat lehtësojnë arritjen e Objektivave për zhvillim të Mijëvjeçarit, dhe
6. Mban seancë vjetore për të diskutuar përparimin e arritur në lidhje me Objektivat për zhvillim të Mijëvjeçarit, bazuar në raportin e Qeverisë.

## KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, më 17 tetor 2008

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se tani e kanë radhën shefat e grupeve parlamentare për t'i prezantuar qëndrimet e grupeve të tyre parlamentare.

A është e nevojshme të bëhet kjo? Nëse jo, atëherë ju falënderoj shumë.

Ju njoftoj se në sallë janë prezentë 101 deputetë, që do të thotë se është numër i caktuar që të mund të hyjmë në proces të votimit.

Prandaj, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 99 vota “për”, 2 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën e Deklaratës së Mijëvjeçarit të Kuvendit të Kosovës.

Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

Prandaj, konstatohet se me këtë rezultat të votimit, mbyllet seanca solemne. Ju njoftoj se jemi të ftuar në koktejt, që është përgatitur nga NDP-ja. Ju faleminderit!

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës**